

Interreg



ADRION


ADRIATIC-IONIAN

European Regional Development Fund - Instrument for Pre-Accession II Fund

IMPRECO



**BUJQËSIA ORGANIKE
ALTERNATIVË E SHËNDETSHME
PËR NJERËZIT DHE MJEDISIN**



Bujqësia organike është sistem prodhimi që ruan shëndetin e tokës, ekosistemeve dhe njerëzve. Ajo bazohet në proceset ekologjike, shumëllojshmërinë biologjike dhe ciklet e përshtatur me kushtet vendore duke shmangur përdorimin e inputeve me efekte të dëmshme. Bujqësia organike kombinon traditën, risitë dhe shkencën në dobi të mjedisit të përbashkët dhe promovon marrëdhënie të drejta dhe cilësi të mirë të jetës për të gjithë njerëzit.

Ky broshurë është përgatitur në kuadër të projektit IMPRECO, i cili ka qëllim kryesor mbrojtjen dhe përmirësimin e shërbimeve të ekosistemit dhe trajtojë ndjeshmërinë e tyre mjedisore duke forcuar potencialin e biodiversitetit të zonave të mbrojtura dhe ruajtjen e ekosistemeve përmes rrjeteve të tyre ndërkombëtare.

Projekti IMPRECO me fokus në praktikën më të mirë për të përmirësuar shërbimet e ekosistemeve në nivel ndërkombëtar me 7 partnerë, financohet nga programi INTERREG Adrion me fondet e Bashkimit Evropian, dhe zbatohet në Shqipëri nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Kjo broshurë u përgatit nga Organizatat "Gruaja në Integritet" dhe "Qendra Burimore e Mjedisit" në Shqipëri në kuadër të Projektit Pilot i cili zbatohet në Shqipëri nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit.



Rëndësia e Bujqësisë Organike

Ruajtja dhe përmirësimi i pjellorisë dhe strukturës së tokës, mbrojtja e shumëllojshmërisë biologjike dhe zvogëlimi i erozionit të tokës.

Kjo lloj bujqësie zvogëlon në maksimum rreziqet e ekspozimit njerëzor, shtazor dhe mjedisor ndaj lëndëve toksike. Praktikrat e bujqësisë organike duhet të përmbushin kushtet e prodhimit vendas si dhe të kënaqin kërkesën e tregjeve në nivel vendor, kombëtar dhe më gjerë.

Cilat janë objektivat e bujqësisë organike?

Objektivat për bujqësinë organike janë: Ruajtja e mjedisit dhe burimeve natyrore, rivendosja e ekuilibrit ekologjik, nxitja e bujqësisë së qëndrueshme, përmirësimi i pjellorisë së tokës, ruajtja e florës dhe faunës, mbrojtja e shumëllojshmërisë gjenetike dhe eliminimit të ndotjes kimike dhe mbetjeve toksike.



Pse Bujqësia Organike është më e mirë se Bujqësia Intensive?

Dallimi thelbësor midis bujqësisë organike dhe atyre konvencionale është se bujqësia konvencionale përdor lëndë kimike për të luftuar dëmtuesit e produkteve bujqësore dhe barërat e këqija, dhe kimikate si shtesë ushqimore për bimët.

Bujqësia organike mbështetet mbi parimet natyrore të shumëllojshmërisë biologjike dhe kompostimit të mbetjeve organike për të prodhuar ushqim të shëndetshëm dhe të bollshëm.

Cilat janë parimet kryesore të bujqësisë organike?



Parimi kryesor është përdorimi i lëndëve, farave dhe mjeteve sipas standardeve dhe rregulloreve të miratuara. Këtu bëjnë pjesë plehrat organikë, përdorimi i lëndëve plehëruese nga kompostimi dhe plehrat organikë të certifikuar që prodhohen nga industria, etj.



Për ujitjen e bimëve, uji merret nga burime ose puse të pastra, pa mbetje kimike. Kështu, nuk lejohet marrja e ujit për vadtje nga kanale ose lumenj të ndotur.



Respektohet qarkullimi bujqësor dhe shmangia e ndotjes nga mbetjet plastike, apo dhe lëndë të ngurta ndotëse (psh. mbetjet mjekësore apo të ngjashme me to). Gjithashtu, duhet të shmangen ndotjet nga ferma fqinje që nuk e praktikojnë bujqësinë organike.



Nuk lejohen farëra të modifikuara gjenetikisht dhe farëra të dizinfektuara me insekticide dhe kimikate të tjera industriale.



Nuk lejohet përdorimi i hormoneve që nxisin artificialisht pjekjen e perimeve dhe frutave apo që shpejtojnë ciklin e prodhimit të bimëve.



Nuk lejohen herbicidet dhe insekticidet.



Ç` është certifikimi i produkteve organike?

Certifikimi është procedura e kontrollit të të gjitha hapave që ka kaluar prodhimi i produkteve bujqësore. Kontrollon teknologjia dhe inputet e përdorura dhe krahasohen ato me standardin përkatës. Kontrollin e kryen inspektori, i cili ka dokumentacionin dhe pyetësin. Pasi e plotëson atë direkt në fermë, ia kalon personave të certifikimit. Ata e shikojnë dokumentacionin dhe nëse nuk konstatojnë shkelje të standardit, atëherë lëshojnë certifikatën e prodhuesit që është e kontrolluar.

Ferma kontrollohet çdo vit dhe certifikata është e vlefshme për 12 muaj. Duhet të kalojnë tre vite që ferma të kalojë plotësisht në BIO. Vitet e mëparshme quhen "Në kalim BIO".

Pasi certifikohet produkti ka të drejtë të dalë në treg me logon "BIO".

Përdorimi i logos "Bio", pa qenë produkt i certifikuar, është shkelje ligjore dhe dënohet si mashtrim i konsumatorit.



Bujqësia Organike në Shqipëri

Bujqësia organike ka kushte të përshtatshme klimatike, shumëllojshmëri të bimëve dhe territorit, si dhe dëshirën e konsumatorëve për produkte vendi dhe natyrale.

Në Shqipëri, qysh nga viti 2004 është miratuar një ligj për bujqësinë organike.

Ministria e Bujqësisë ndjek zbatimin e politikave në bujqësinë organike.

Instituti për Bujqësinë Organike është hapur që prej vitit 2009 në Shkozë, Durrës. Një trupë certifikimi e akredituar, e quajtur "Albinspekt", kontrollon produktet organike dhe Bio.

Vendi ynë, me fokus në zhvillimin e turizmit, ka mundësi për zhvillimin e bujqësisë organike dhe BIO. Fermat organike po rriten në numër dhe sipërfaqe. Mbi 250 ferma prodhojnë produkte organike. Produktet e prodhuara janë perimet, erëzat e kuzhinës, vaj ulliri, bimë mjekësore, kërpudha pylli, rrush dhe verë. Qysh nga viti 2008 ka filluar mbështetja financiare e fermave që marrin certifikatën organike ose Bio. Këtu vlen të theksohet suksesi i eksportit të vajit të ullirit, kryesisht në tregun zviceran. Zonat ku është përqëndruar bujqësia organike dhe Bio janë Tirana, Durrësi, Vlora, e së fundi edhe Shkodra.



Bujqësia Organike në botë

Në shkallë botërore Bujqësia Organike praktikohet në rreth 70 milion hektarë dhe tregu rritet çdo vit me 25 përqind.

Vendet me përqindjen më të madhe me Bujqësi Organike, në raport me tokën bujqësore që zotërojnë, janë: Zvicra, Austria, Greqia, Suedia, Italia (Jugore), Lihtenstein. Shumë vende të vogla kanë përqindje të lartë të Bujqësisë Organike meqë ajo është një alternativë për të rritur konkurrueshmërinë në tregun e hapur global.

Shkodra ...

Në dallim nga qarqet e tjera, Shkodra ka numrin më të madh të produkteve tradicionale që përfshijnë që nga kultivarët e fushës, gatimet e veçanta të zonës, kafshë, bimë të egra dhe peshq të detit dhe liqenit.

Ullinjtë: Ullinj të bardhë, vaj ulliri

Vreshtat: Kallmet

Frutat: Shegët, qershitë

Frutat e arrave: Gështenja, arra

Duhani: Duhani nga Sheldia

Bishtajore: Fasule

Patatet: Patatet nga Velipoja

Perimet: Okra dhe specat nga Oblika

Zarzavate pa gjethe: Lakër dhe qepë nga

Drishti

Drithëra: Misër Rozafa

Grappa: kumbull, korne, manit dhe rrushit

Bujqësia: dele, dhi, derra, djathë, gjalpë, mish të thatë

Bimët mjekësore: sherebelë dhe tymë

Verë: verë Kallmet

Bletari: gështenjë dhe mjaltë e urtë

Pjatat tradicionale: tavë karpi, qull misri, tavë pule dhe qull, mish dhie dhe qengji

Ushqim i përpunuar dhe i fermentuar:

domate, piper, kastravec dhe turshi lakër

Punime artizanale: produkte prej leshi të punuara me dorë dhe pambuku, gdhendje në dru

Peshkimi: krap, mushkë e kuqe, karkaleca, bas evropiane, ngjala, brek deti, mushka



Interreg



EUROPEAN UNION

ADRION

ADRIATIC-IONIAN

European Regional Development Fund - Instrument for Pre-Accession II Fund

IMPRECO



Partnerët e projektit



"Kjo fletëpalosje është prodhuar me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e fletëpalosje është përgjegjësi e vetme e Fondit Shqiptar të Zhvillimit / PP6 dhe në asnjë rast nuk mund të konsiderohet si pasqyrim i pozitës së Bashkimit European dhe / ose të autoriteteve të programit ADRION ".

Kjo broshurë u përgatit nga Organizatat "Gruaja në Integrim" dhe "Qendra Burimore e Mjedisit" në Shqipëri në kuadër Projektit Pilot, i cili zbatohet në Shqipëri nga Fondit Shqiptar të Zhvillimit

